



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.56/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli, Kryesues, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterave në objekte në pronësi shtetërore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me 19.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.56/2025 e datës 17.01.2025
- II. Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 3,500.00 (tremijepesëqind) euro,
- III. Detyrohet Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 17.01.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, (LVV), me të cilën pretendon se më 16 Janar 2025, Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Skenderaj ka identifikuar posterin e vendosur në hapësirat e organeve shtetërore në rrugën “Fadil Rrustemi”, në Skenderaj, ku me këtë veprim subjekti PDK ka shkelur dispozitat e legjislacionit neni 7 paragrafi 2.4 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 18.01.2025, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) theksohet se, Partia Demokratike e Kosovës, më datë 17.01.2025, përmes rrjetit social Facebook i’u është adresuar të gjithë anëtarëve, aktivistëve dhe përkrahësve të PDK-së, duke i bërë thirrje të njëjtëve që gjatë kësaj periudhe kohore të fushatës të përdorin gjuhë të respektueshme, të shmangin çdo gjuhë nxitëse, fyese ose urrejtjeje si dhe të respektojnë ligjet dhe rregullat zgjedhore, të cilat përveç se përbëjnë detyrim ligjor, është edhe përgjegjësi morale që forcon demokracinë dhe ndërton themelet për suksesin e

përbashkët. Provë: Adresimi i Partisë Demokratike të Kosovës përmes rrjetit social Facebook, i datës 17.01.2025, përmes linku:

<https://www.facebook.com/PDKqender/posts/pfbid02gaDdAzL5rztq9YEueiZdthyqwf5EMc3yFXzdujwn4XqWEQHFK9TGeH8L2mRxWgJt1>

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës gjeti se:

-Ankesa është e bazuar

Paneli, nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se subjekti politik PDK, ka vendosur postera të kandidatëve për deputet nga radhet e këtij subjekti, në hapësira të ndërtesës publike, në palestrën Ilaz Kodra, dhe më të njëjtin veprim subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, PDK, ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP, konkretisht neni 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i LZP-së parasheh: "1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërës si në vijim: 1.2 vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa leje e pronarëve ose shfrytëzuesve, si dhe neni 7 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, i cili parasheh: *Materiali i subjekteve politike nuk duhet të vendoset, në objekte në pronësi shtetërore.*

Neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, thekson se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) Euro.

Përveç kësaj një veprim i tillë sanksionohet edhe me nenin 24 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 Rregullës Nr.01/2024, ku përcaktohet se "subjekti politik që është përfitues i fondeve për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në njëzetmijë (20, 000.00)euro.

Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik PDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i

njoftuar me rregullat zgjedhore. ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe të njëjtit subjekt politik për shkelje për afërsisht të ngjashme në zgjedhjet aktuale për Kuvend të Republikës së Kosovës i është shqiptuar gjobë. Paneli po ashtu me rastin e përcaktimit për lartësinë e gjobës, ka marr parasysh edhe përgjigjen në ankesë të subjektit politik PDK, ku nga fotot e printuara të bashkangjitura përgjigjes në ankesë, dëshmohet se janë larguar posteret e kandidatëve për deputet nga radhët e këtij subjekti, në hapësira të ndërtesës publike, në palestrën Ilaz Kodra, dhe kjo vlerësohet nga ana e panelit ndërmarrje e masave përmirësuese, e cila pastaj ka rezultuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendim.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin të pabazuara, të pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore si në dispozitat e Ligjit për Zgjedhje, dhe si të tilla nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka Paneli, vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenit 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nënparagrafi 1.3, të LZP-së, nenit 10 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 56/2025 më datë 19.01.2025

Kryesues i Panelit
Kujtim Pasuli



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.